

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Albulena Haxhiu rizgjidhet kryetare e Kuvendit të Kosovës: Faleminderit për besimin!
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/lajm-i-fundit-albulena-haxhiu-zgjidhet-kryetare-e-kuvendit-te-kosoves-i400775
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 09:43:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 09:38:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	699866782f878cc43fb18b5ecd67585e038ea440265469f17a6c45001f4b280b
TEKSTI	13cbaaaa6076f5803726a0032dea2f042cf22be495e95a90a093766cd297ff7c
PAMJA	6a6d3b65109529500153bdc33ac5461c6fe3b7a35e6969c870495adae94a5e02

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cf4a30b4b1e920190fc8de954db11142ad992b39de7df6e3af4f6ab6f65ace2f
E MËPARSHMJA	61e37190fb8bb0647c0d38989a51b0cd5a53402f936dc29fe5d81dad1969136a
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cf4a30b4b1e920190fc8de954db11142ad992b39de7df6e3af4f6ab6f65ace2f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Rajoni](#) 9 Shtator 2026, 11:38

Albulena Haxhiu rizgjidhet kryetare e Kuvendit të Kosovës: Faleminderit për besimin!

Shkruar nga Newsbomb



 Albulena Haxhiu rizgjidhet kryetare e Kuvendit të Kosovës:

Albulena Haxhiu

Albulena Haxhiu do të vijojë të jetë në krye të Kuvendit të Kosovës, pasi është zgjedhur kryetare me 62 vota pro. Vendimi u mor mesditën e kësaj të mërkure, në seancën e Kuvendit të Kosovës, ku 62 deputetë të pranishëm votuan në favor të kandidaturës së Haxhiut.

Kandidatura e saj u propozua nga Glauk Konjufca, nga Lëvizja Vetëvendosje, i cili kërkoi mbështetjen e deputetëve për Haxhiun në drejtimin e institucionit ligjvënës të vendit.

Pas shpalljes së rezultatit, Albulena Haxhiu, e cila ushtron dhe postin e presidentes në detyrë, falënderoi deputetët për mbështetjen e dhënë dhe për besimin për të vijuar punën në krye të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

“Dua t’ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen që më keni dhënë për të qenë në krye të Kuvendit të Kosovës”, u shpreh Haxhiu në fjalën e saj të shkurtër.

Me 62 vota pro, Haxhiu merr kështu drejtimin e Kuvendit të Kosovës, duke vijuar të jetë në krye të një prej institucioneve kryesore të vendit.

Kush është Albulena Haxhiu:

Albulena Haxhiu është pjesë e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), teksa u rizgjodh sqrish këtë të mërkurë në postin e Kryetares së Kuvendit. Me t’iu bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje, Haxhiu është zgjedhur deputete e legjislaturës së katërt të Kuvendit të Kosovës në periudhën 2011- 2014.

Ajo ka qenë deputete shtatë herë radhazi, derisa në katër legjislaturat e fundit është emëruar në pozita tjera, ministre, nënkryetare e Kuvendit, kryetare e Kuvendit si dhe presidente në detyrë.

Si deputete, ajo e ka udhëhequr për dy mandate Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Më 2020, Haxhiu është emëruar ministre e Drejtësisë, dhe është riemëruar në atë pozitë edhe në Qeverinë e radhës të formuar më 2021.

Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit dhe 28 dhjetorit 2025, ajo ishte gruaja më e votuar, në procesin e parë zgjedhor i fitoi mbi 125 mijë vota, në të dytin mbi 174 mijë sosh.

Nga protestat në rrugë deri te Presidenca

Sa ka qenë në opozitë, Haxhiu është parë pothuajse gjithmonë në ballë të protestave të Lëvizjes Vetëvendosje, për çka është arrestuar disa herë.

Më 2018, pas një procesi disavjeçar, Haxhiu është dënuar me kusht nga Gjykata Themelore në Prishtinë për hedhje të gazit lotsjellës e pengim të personit zyrtar, veprime të cilët ajo dhe deputetë tjerë të Lëvizjes Vetëvendosje i ndërmorën për ta penguar ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe Marrëveshjen për Asociacionin e komunave me shumicë serbe.

Ajo u përfshi në tensione edhe në korrik të vitit 2023 sa ishte ministre e Drejtësisë.

Bërtatë në seancën të Kuvendit, Haxhiu nënshkroi fjalëkth me deputetë e Partisë Demokratike të Kosovës, Mirësin Lushajën, i cili shpirti me një kryeministër të Kosovës, Albin Kurti, teksa në

U zgjedh një shokë në Kuvendin, themelues përparës i bashkësive të Kosovës, dhe grupi në një grupim të Kosovës, themelues, bashkëpo fliste në foltore.

Më herët gjatë vitit, Gjykata Themelore në Prishtinë e ka refuzuar një aktakuzë ndaj Haxhiut, dhe disa ish-deputetëve tjerë, të cilët akuzoheshin për posedim të gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës më 2016, duke i dhënë fund një procesi të gjatë gjyqësor.

Kryetarja e Kuvendit është e lindur më 11 maj 1987 në Prishtinë.

Studimet i ka përfunduar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe në Universitetin e Evropës Juglindore, në drejtimin e të drejtës penale.

Haxhiu është e martuar me ish-anëtarin e LVV-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Alban Krasniqin, dhe i ka tre fëmijë.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Rajoni

[U shoqërua bashkë me Lapajn pasi protestoi para Kuvendit, lirohet gazetari Shpend Gashi: Na dha Rama një "dekoratë"](#)

E Martë 22:55

Rajoni

[Pas shpërndarjes së qeverisë, Vuçiç del me DATË: Ja kur do të mbahen zgjedhjet e parakohshme në Serbi](#)

E Martë 21:36 Newsbomb

Rajoni

[Hodhi gaz lotsjellës në Kuvend në 2018, Ministri i Brendshëm i Kosovës dënohet me një vit burg](#)

E Martë 09:58

Rajoni

[Sarajeva tërheq stafin e ambasadës nga Serbia pas varrimit të Mlladiçit me nderime shtetërore](#)

E Hënë 18:26

Rajoni

[Serbia kalon në zgjedhje të parakohshme, kryeministri Macut propozon shpërndarjen e qeverisë! Vuçiç do të caktojë datën](#)

E Hënë 17:50

Rajoni

[TRAGJEDI në Kosovë/ Vëllai i vë flakën së motrës dhe plagos rëndë nënën, vajza ndërroi jetë në spital \(DETAJE\)](#)

E Hënë 16:25

Rajoni

[Nderimet për Ratko Mladiç/ Vuçiç dërgon të birin dhe disa ministra në ceremoninë e varrimit, ndërpritet sinjali i televizioneve serbe në Bosnjë e Hercegovinë](#)

E Hënë 15:21

Rajoni

[Ëndërronte të bëhej mjek për të shpëtuar jetë, ky është 16-vjeçari që u gjet i vdekur pranë shtëpisë së tij, dyshohet se u vra me armë \(FOTO-EMRI\)](#)

E Hënë 13:02 Newsbomb

Rajoni

[Vajza pa babanë të mbuluar nga gj*ku, DETAJE nga atentati në Greqi: Shqiptari dyshohet se u plagos për motoçikletën, dëshmojnë banorët \(EMRI\)](#)

E Hënë 11:28 Newsbomb

Rajoni

[TRAGJIKE në Rahovec, i mituri gjendet i pajetë para shtëpisë së tij, dyshohet se është vrarë me armë zjarri](#)

E Hënë 10:11 Newsbomb

Rajoni

[Dy persona shënjestrojnë shqiptarin në orët e para të mëngjesit, e qëllojnë me disa plumba dhe zhduken me vrap nga vendngjarja \(DETAJE\)](#)

E Hënë 07:30 Newsbomb

Rajoni

[Arrestohet shoferi i një zyrtari të lartë në Maqedoninë e Veriut, dyshohet se kërkoi 1.500 euro për një vend pune](#)

E Diel 17:26

Rajoni

[Greqia me paketë të re ekonomike, pensionet rriten deri në 400 euro, paga minimale e kalon 1 mijë euroshin](#)

E Diel 12:30 Newsbomb

Rajoni

[I doli para me thikë kuzhine, shqiptari i merr hak marokenit në Itali, i shkon nga pas dhe e bën për spital, shkak dyshohet një vajzë \(DETAJE\)](#)

E Diel 10:22 Newsbomb

Rajoni

[2000 serbë në masakrën ndaj Jasharëve, DETAJE: Shtëpia e komandantit të UÇK-së u vëzhgua disa muaj, plumbat kapën foshnje e të mitur](#)

E Diel 08:14 Newsbomb

Rajoni

[Do të xhironte filmin e ri, aksidenti tragjik i merr jetën regjisores greke](#)

E Shtunë 21:13

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Politikë

[Protestuesit sulmuan Iris Luarasin, Edi Rama ju shkruan Demokratëve Europianë: A nuk ju vjen turp që mbështesni një sjellje kaq të neveritshme dhe e shisni si mospajtim demokratik?](#)

E Mërkurë 12:01

Aktualitet

[Mungesa e pagave fut në kolaps të gjitha Gjykatat, bojkot nga Tirana në Sarandë, avokati: Të lajmëroheshin qytetarët që s'do ketë shërbime](#)

E Mërkurë 11:47

[Zbuloj më shumë artikuj.](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)



[E pazakontë tek "Mbretëresha Geraldinë", vjen në jetë në lindje me natyrale djali me peshë 5.1 kg](#)



[Goditet grupi i drogës në Sarandë, 20 persona të prangosur, shpërndanin lëndën narkotike](#)



[U zhvatën 100 mijë euro qytetarëve duke i mashtruar, 27-vjeçarja me një tjetër grua i gënjenin se...](#)

**op
ed**

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor](#)

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse "Jo"-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë](#)

E Diel 18:33



-
-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtör i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

Abonohu te Revista

Created and monetized by  mediadesk

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

Merr lajme me email

ME REGJISTRO

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.